



BURSA STUDIMI “THAI SCHOLARSHIP YEAR 2022” TË OFRUARA NGA QEVERIA E MBRETËRISË SË TAJLANDËS

Qeveria e Mbretërisë së Tajlandës ofron bursa studimi për studentë të huaj për vitin akademik 2022, në programet studimore bachelor, master dhe doktoratë, në institucione të ndryshme arsimore në Tajlandë. Disa nga fushat e studimit të ofruara janë:

- Atletikë;
- Teknologji;
- Inxhinieri;
- Financë;
- Urbanistikë;
- Biznes, logjistikë dhe transport;
- Pasuri të paluajtshme etj.

Bursa mbulon në masën 50-100% shpenzimet në varësi të universiteteve dhe programeve të përzgjedhura. Të gjitha programet janë të disponueshme në anglisht dhe në gjuhën tajlandeze.

Të interesuarit duhet të kontaktojnë me koordinatorin e çdo universiteti për detaje të mëtejshme përpara aplikimit në programet e dëshiruara dhe më pas duhet të dorëzojnë aplikimet drejtpërdrejt në institucionet pritëse brenda afatit të aplikimit të çdo programi, i cili ndryshon në varësi të universitetit të përzgjedhur. Procesi i përzgjedhjes do të bëhet nga komisioni pritës i institucioneve përkatëse.

Më shumë informacion në lidhje me universitetet dhe kushtet e aplikimit i gjeni në linkun e mëposhtëm:

<http://bit.ly/3J6UYg3>

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE
ASISTENCËS**